



DALESE - IZLANA - OUTGOING

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal  
Ministarstvo lokalne samouprave i administracije  
Ministry of local government administration

Nr. Br. 43-66  
No. 43-66  
Data Datum 14.02.2007  
Date 14.02.2007



**INSTITUCIONET E PËRKOHSHME VETËQEVERISËSE  
PRIVREMENA INSTITUCIJA SAMOUPRAVE  
PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT**

**QEVERIA E KOSOVËS / MINISTERIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
VLADA KOSOVA / MINISTARSTVO FINANCIJA I EKONOMIJE  
GOVERNMENT OF KOSOVO/MINISTRY OF FINANCE AND ECONOMY**

Në pajtim me Rregulloren e UNMIK 2001/9 “Mbi Kornizën Kushtetuese të Kosovës”, Kreu 5.2, Rregulloren e UNMIK 2000/45 “Mbi Vetëqeverisjen e Komunave në Kosovë”, duke marrë parasysh Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2001/19, “Mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë”, Neni 1.3 (d); Rregulloren e UNMIK-ut 2005/15 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2001/19 Mbi Degën Ekzekutive të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë” Shtojca XIV (iii) (d) dhe Ligjin mbi Menaxhimin Financat Publik dhe Përgjegjësitë shpallur me Rregulloret e UNMIK 2003/17, Ministri i Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministri i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nxjerrin këtë:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV Nr. 2007/2**

**PËR TË HYRAT VETANAKE TË KOMUNAVE**

**Neni 1  
Qëllimi**

1.1 Ky udhëzim administrativ ka për qëllim përcaktimin dhe sqarimin e burimeve të të hyrave vetanake të komunave në bazë të përgjegjësisë që i janë dhënë me Rregulloren e UNMIK 2000/45.

1.2 E drejta për caktimin e burimeve të të hyrave nga ngarkesat, tarifat, licencat, gjobat, dhe të hyrat nga mjetet sipas komunave, është në kuadër të fushës së të drejtave të dhëna kuvendeve komunale të Kosovës nën Rregulloren e UNMIK-ut 2000/45, Neni 39 dhe Neni 11.3.

1.3 Të gjitha të Hyrat vetanake të komunave janë pjesë e Fondit të Konsoliduar të Kosovës, dhe iu shpërndahen komunave për shpenzim në bazë të dispozitave të LMFPF.

MINISTRIA E EKONOMISË DHE FINANCAVE  
MINISTARSTVO ZA PRIVREDU I FINANSIJE  
MINISTRY OF ECONOMY AND FINANCE

Kabineti i Ministrisë - Kabinet Ministra - Cabinet of Minister

Ref. No: -116-

Dt: 13.02.2007

Nënshkrim:  
Folcic:  
Signature: [Signature]

HK

**Neni 2**  
**Llojet e të Hyrave Komunale**

Në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe udhëzimet e nxjerra, të hyra komunale janë këto:

1. Tatimin në Pronën e Paluajtshme,
2. Ngarkesat për Shërbimet Komunale,
3. Tarifat për Shërbimet Administrative Komunale,
4. Gjobat në Trafik dhe Gjobat për Shkeljen e Rregulloreve Komunale dhe
5. Të Hyrat të tjera të lejuara me ligj.

**Neni 3**  
**Tatimi mbi Pronën e Paluajtshme**

3.1 Sipas Rregullores së UNMIK-ut 2003/29, Komunitat mund të vjelin tatimin mbi pronën e paluajtshme nëse posedojnë certifikimin e vlefshëm të lëshuar nga Ministria për Ekonomi dhe Financa.

3.2 Pronat e paluajtshme të cilat janë të përjashtuara nga tatimi në pronë janë të specifikuar në nenin 7 të Rregullores së UNMIK-ut 2003/29. Asambletë Komunale nuk kanë kompetenca për të bërë përjashtime tjera për kategori tjera të pronave ose për tatimpagues individual. Komunitat duhet të vlerësojnë dhe të detyrojnë pagesën e tatimit në pronë për të gjitha pronat të cilat nuk janë të përjashtuara.

3.3 Tatimpaguesve individual të cilët marrin asistencë sociale u lejonet shtyrja e pagesës së tatimit në pronë në objektet e banimit primar derisa prona për të cilën është shtyrë tatimi të bartet te një pronar tjetër. Neni 15 i Rregullores së UNMIKU-ut 2003/29, dhe Neni 8 i Udhëzimit Administrativ i Ministrisë për Ekonomi dhe Financa Nr. 2003/11, vendos kriteret dhe procedurat për shtyrjen e pagesës së tatimit në pronë.

3.4 Si e vetmi tatim mbi bazën e vlerës së tregut i administruar nga komunitat dhe i bazuar në pasurinë relative të tatimpaguesit, tatimi në pronë është menduar të jetë burimi primar i të hyrave të komunave.

HR



#### **Neni 4**

##### **Tarifat për Shërbime Komunale**

4.1 Komunat kanë të drejtë të caktojnë ngarkesa për shërbime administrative të caktuara që i sigurohen qytetarëve, personave fizikë dhe juridikë që ushtrojnë aktivitet në territorin e komunës.

4.2 Tarifat për shërbime nuk duhet të tejkalojnë koston e ofrimit të shërbimit dhe përcaktohen me rregullore komunale të miratuara nga Kuvendi i Komunës.

4.3 Tarifat për shërbime administrative duhet të reflektojnë shpenzimet e fuqisë punëtore, kohën e punës, materialeve dhe pajisjeve të përdorura për të siguruar shërbimet.

4.4 Tarifat për këto shërbime mund të zbatohen si shtesë e tarifave për lëshimin e lejeve, licencave, dokumenteve, ose lejet tjera për të udhëhequr disa aktivitete.

4.5 Tarifat për shërbime aplikohen në fushat në vazhdim:

a. Shërbimet e inspektimit lidhur me shëndetin dhe sigurinë; siç janë inspektimet e konstruksionit të ndërtesës, inspektimet e sigurimit nga zjarri, inspektimi i shërbimeve ushqimore dhe të restoranteve, inspektimit i sigurisë në vendin e punës, dhe të gjitha aktivitetet tjera lidhur me shëndetësinë, sigurimin, inspektimin sanitar dhe aktivitete të tjera të ngjashme.

b. Kryerja e shërbimeve profesionale siç janë studimi i tokës dhe kadastrës, shënjimi i sipërfaqeve dhe parcelave, vëzhgimi i tokës dhe i pronës dhe aktivitete të ngjashme sipas ngarkesave të caktuara nga Agjencioni Kadastral i Kosovës ose me rregullore të Kuvendit të Komunës.

c) Tarifat për inspektime të tregut dhe aktivitete të ngjashme.

#### **Neni 5**

##### **Tarifat për Lëshimin e Vërtetimeve dhe Dokumenteve Zyrtare**

5.1 Komuna kanë të drejtë të caktojnë tarifa për lëshimin e vërtetimeve ose dokumenteve zyrtare në lidhje me kurorëzimin, lindjet, shkurorëzimin gjendjen ekonomike, sociale ose vërtetime dhe dokumente të tjera të ngjashme.

5.2 Tarifat për lëshimin e dokumenteve zyrtare nuk duhet të tejkalojnë koston e ofrimit të shërbimit dhe përcaktohen me rregullore komunale të miratuar nga Kuvendi i Komunës..

5.3 Komuna kanë të drejtë të caktojnë tarifa shtesë për lëshimin e kopjeve shtesë të vërtetime dhe dokumenteve origjinale.

*HR*

## Neni 6 Ngarkesat për ushtrimin e Veprimtarisë Afariste

- 6.1 Komunitat kanë të drejtë të caktojnë tarifa për ushtrimin e veprimtarisë afariste brenda kufijve të komunës. Ngarkesa për të ushtruar veprimtari caktohet vetëm pasi subjekti paraqet provë regjistrimit në institucionin përgjegjës.
- 6.2 Ngarkesat për kategori të ndryshme të veprimtarive afariste përcaktohen me rregullore të miratuara nga Kuvendi i Komunës. Ngarkesat për lejen e ushtrimit të veprimtarisë afariste mund të caktohen në bazë të përtëritjes vjetore .
- 6.3 Ngarkesa për ushtrimin e veprimtarisë afariste caktohen sipas vlerësimit të Kuvendit të Komunës por duhet të jenë të njëjta për të gjitha bizneset që i nënshtrohen të njëjtave kritere vlerësimi.
- 6.4 Ngarkesa mund të bazohen me llojin e veprimtarisë afariste, siç janë; veprimet bankare, sigurimi dhe/ose shërbimet financiare; lloje të caktuara të ndërmarrjeve të tregtisë me pakicë; ndërmarrjet për shërbime ushqimore; shërbimet hoteliere; dhe aktivitetet tjera afariste.
- 6.5 Ngarkesat mund të bazohen gjithashtu me madhësinë e hapësirës fizike për metër katrorë e zënë nga veprimtaria tregtare ose ndërmarrja.
- 6.6 Komunitat mund të caktojnë ngarkesa të ndryshme për ushtrimin e veprimtarisë afariste bazuar në zonën ku ushtrohet veprimtaria si qendër, periferi, zonë industriale ose zona të tjera që dallojnë nga njëra tjetra.
- 6.7 Komuna përveç ngarkesave të rregullta për ushtrimin të veprimtarisë afariste mund të caktojnë leje speciale dhe ngarkesë shtesë për shërbimin e pijeve që përmbajnë alkool brenda ndërmarrjes.
- 6.8 Ngarkesa për ushtrimin e veprimtarisë afariste mund të bazohen edhe në karakterin e mjediseve të zëna nga veprimtaria tregtare varësisht nga vendi ku operojnë si zyre, shitore, tezgja tregu, ose ato që operojnë në kioska, taksi, etj.
- 6.9 Ngarkesa për ushtrimin e veprimtarisë afariste caktohet për çdo ndërtesë ku ushtrohet veprimtaria brenda kufijve të komunës. Nëse një person juridik ushtron veprimtari tregtare në më shumë se një godinë afarizmi brenda kufijve të komunës, leja kërkohet për secilën godinë afarizmi.
- 6.10 Ngarkesat për ushtrimin e veprimtarisë afariste nuk mund të bazohen në asnjërën nga karakteristikat e mëposhtme:
- a. Numrin e punonjësve në veprimtarinë afariste;
  - b. Volumin e veprimtarisë ekonomike; siç është: qarkullimi, prodhimi, ose ndonjë tregues tjetër i ngjashëm, dhe
  - c. Fitimet ose rrjedhja e parave të realizuara nga veprimtaria tregtare

HSL



6.11 Organi kompetent për dhënien e lejes duhet të sigurojë dëshmi se ushtrimi i veprimtarisë afariste është në pajtim me rregulloret komunale të zbatueshme.

#### **Neni 7**

#### **Tarifat për Lejet për Punë Profesionale**

7.1 Komunitat kanë të drejtë të caktojnë tarifa për dhënien e lejeve për punë të caktuara profesionale brenda komunës (operimi me aktivitetin e tyre afarist brenda komunës).

7.2 Lejet për punë profesionale për llogaritarët, mjekët, avokatët, dentistët dhe profesionet e tjera të njohura lëshohen vetëm pasi subjekti kërkuar paraqet dëshmitë e mëposhtme;

Dëshmi të arsimit përkatës siç janë; diplomat akademike dhe certifikatat e testimeve profesionale;

Dëshmi e përbushjes së kërkesave ligjore për ushtrimin e profesionit; dhe

Dëshmi të trajnimeve kualifikuese të tjera.

7.3 Komunitat mund të caktojnë tarifa të ndryshme për profesione të ndryshme.

#### **Neni 8**

#### **Ngarkesat për Lejen e Pronësisë së Automjeteve**

8.1 Komunitat kanë të drejtë të caktojnë ngarkesat për banorët, bizneset ose etnitetet e tjera kosovare që kanë në pronësi automjete.

8.2 Ngarkesa për pronësinë e automjeteve për banorët, bizneset ose etnitetet e tjera kosovare aplikohet vetëm kur pronari paraqet në komunë dokumentet e mëposhtme :

a. Dëshminë e pronësisë së automjetit;

b. Një adresë me qëndrim të përhershëm të shtëpisë ose biznesit brenda komunës dhe

c. Nëse automjeti i përket një aktiviteti tregtar ose profesional, lejen për ushtrimin e veprimtarisë tregtare ose leje të punë profesionale.

8.3 Ngarkesat për pronësinë e automjetit përcaktohen me rregullore të Kuvendit të Komunës dhe mund të bazohen në llojin e automjetit dhe brenda këtij klasifikimi madhësinë ose peshën e automjetit dhe fuqinë motorike të tij.

8.4 Kuvendi i Komunës përmes rregulloreve mund të përjashtojë nga ngarkesat ose mund të zvogëlojë ngarkesat për ato automjete që përdoren për shërbimet emergjente, janë në pronësi të individëve me aftësi të kufizuara ose invalidë, ose karakteristika tjera lidhur me pronarin ose poseduesin.

8.5 Ngarkesat për pronësinë e automjeteve mund të bashkohen me ngarkesat për parkimin brenda kufijve të komunës.

HR

8.6 Komunitat mund të caktojnë gjoha/dënime për shkelje të rregullave të lejes për vetura.

### **Neni 9**

#### **Ngarkesat për Dhënie në Përdorim të Pronës Komunale**

9.1 Komunitat kanë të drejtë të caktojnë ngarkesa për përdorimin e pronës komunale, pajisjeve ose tokës që shfrytëzohet nga individë, biznese ose entitete të tjera jo-keqeritare duke përfshirë tabelat për reklamat.

9.2 Baza për këtë ngarkesë duhet të jetë vlera reale e tregut me qira për shfrytëzimin e hapësirave të ngjashme.

9.3 Ngarkesat për marrjen me qira ose përdorimin e ndërtesave dhe tokës duhet të bazohet në vlerën e qirasë për metër katror ose dimensioneve tjera matëse të hapësirës, vendndodhjen e tokës dhe llojin e përdorimit, qoftë tregtar, për banim ose për punë profesionale.

9.4 Komunitat mund të caktojnë ngarkesa për ato biznese ose entitete tjera; siç janë kafiteritë, kioskat, tavolinat për shitje, restorantet ose bizneset tjera aktivitetet e të cilave shtrihen në pronë publike, si p.sh. trotualet, rrugët, ose toka.

9.5 Ngarkesat nuk mund të caktohen në bazë të të hyrave ose përqindjeve të shitjeve të realizuara nga përdorimi i pronës nga ndërmarrja, tregtare ose afariste.

Komunitat mund të aplikojnë vlerë më të ulët se ajo e tregut për pronën komunale që përdoret për banim social dhe ne rastet kur Kuvendi Komunal vendos ndryshe.

### **Neni 10**

#### **Tarifat dhe Ngarkesat tjera të lejuara**

10.1 Komunitat mund të caktojnë tarifa/ngarkesa për fusha të ndryshme të aktiviteteve siç vijon:

- a) tarifa për parkimin e veturave në pronën e komunës
- b) tarifa për përdorimin e pronës komunale për rekreacion, duke përfshirë edhe kampingun,
- c) tarifa për leje për gjueti ose peshkim brenda kufijve të komunës ose në tokë të komunës
- d) tarifa për bërjen e ceremonive ose funksioneve të ndryshme nga zyrtarët e komunës: si p.sh. për martesë etj.
- e) tarifa për reklamim ose për ekspozime tjera brenda kufijve të komunës dhe në pronë të komunës.

### **Neni 11**

#### **Ngarkesat për shfrytëzimin e Burimeve Natyrore**





Komunat kanë të drejtë të vjelin ngarkesa për shfrytëzimin e burimeve natyrore që ndodhen në territorin e komunës si mineralet, pyjet etj. në bazë të legjislacionit në fuqi.

## **Neni 12**

### **Miratimi i Tarifave dhe Ngarkesave Komunale**

12.1 Para se Kuvendi Komunal të miratoj një rregullore mbi tarifën dhe ngarkesat komunale, tarifën dhe ngarkesat e propozuara duhet të rishikohen dhe të aprovohen nga Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal, nga Komisioni për certifikimin e Rregullores të Tarifave, Ngarkesave dhe gjobave komunale, të përbërë nga MEF dhe MAPL.

12.2 Paraqitja në Ministrinë për Ekonomi dhe Financa dhe Ministrinë për Administrimin e Pushtetit Lokal duhet të bëhet së paku 30 ditë para shqyrtimit nga Kuvendi Komunal. Ministria për Ekonomi dhe Financa dhe Ministria për Administrimin e Pushtetit Lokal duhet të sigurojnë rishikim dhe aprovim brenda 30 ditësh pas pranimit të Draft rregullores ( të aprovuar nga Komiteti për Politikë e Financa).

12.3 Komunat duhet t'i sigurojnë Ministrisë për Ekonomi dhe Financa dhe Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal listën e tanishme të komunës të tarifave dhe ngarkesave për rishikim dhe aprovim. Shkelja e çfarëdo dispozite të këtij udhëzimi administrativ duhet të përmirësohet nga kuvendi komunal brenda 60 ditësh pas njoftimit nga Ministria për Ekonomi dhe Financa se tarifën dhe ngarkesat e caktuara nuk janë të lejueshme.

12.4 Çfarëdo tarife dhe ngarkese që është në kundërshtim me rregulloret në fuqi do të pasojë me masa ndëshkuese që do të aplikohen nëpërmes granteve komunale apo transfereve në komunë prej Ministrisë për Ekonomi dhe Financa.

## **Neni 13**

### **Tarifat dhe Ngarkesat për Ndërtimin dhe Rrënimin e Ndërtesave**

13.1 Komunat mund të caktojnë tarifën për dhënie të lejeve të ndërtimit të ndërtesave si dhe ngarkesa për shkatërrim të ndërtesave të autorizuara për veprim të tillë.

13.2 Tarifën e lejes mund të caktohen në bazë të sipërfaqes për metër katror me rregullore komunale të miratuara nga Kuvendi i Komunës.

13.3 Si shtesë për tarifën e lejes, komuna mund të caktojë ngarkesa për rrënimin e strukturave. Tarifën për rrënimin e strukturave bazohen në llogaritje të arsyeshme të mbulimit të kostos për rrënimin, inspektimin dhe mbikëqyrjen e rrënimin të strukturave nëse rrënimi është ekzekutuar nga komuna. Nëse struktura është rrënuar nga ndërtuesi ose pronari, ngarkesa për rrënim do të jetë llogaritja e shpenzimeve të inspektimit dhe mbikëqyrjes së rrënimin nga zyrtarët komunal që janë kompetent për inspektimin e ndërtesave komunale.

HK

13.4 Të gjitha tarifat dhe ngarkesat e mbledhura nga komuna për qëllime të tilla do t'i menaxhojë vet komuna.

#### **Neni 14**

##### **Ngarkesat e Ndikimit mbi Infrastrukturë të Ndërtimeve ose Punimeve**

14.1 Komunat kanë të drejtë të caktojnë ngarkesa të ndikimit të ndërtimeve ose punimeve të kryera mbi infrastrukturën komunale. Ngarkesat mund të aplikohen për shkak të ndikimit negativ të ndërtimit të ndërtesave të mëdha tregtare ose industriale, ose ndërtimit të më shumë se katër njësi banimi në një vend të vetëm ndërtimi ose për kryerjen e punëve si çarja e rrugëve ekzistuese, dëmtimi i kanalizimeve ose rrjetit.

14.2 Këto tarifa mund të bazohen në shpenzimet që do të nevojiteshin për kthimin e infrastrukturës në gjendjen e mëparshme ose mirëmbajtjen e rrugëve të shkaktuara nga vëllimi ose pesha e trafikut mbi rrugët e përdorura, nevojat për shërbime komunale shtesë, ndërtimet ose kanalizimet e siguruara nga komuna, kërkesat për shërbime komunale shtesë, ose faktorët të tjerë të shpenzimeve për komunën që lidhen qartë me ndërtimet dhe veprimtaritë e ardhshme të lidhura me ndërtimet e propozuara.

#### **Neni 15**

##### **Gjobat në Trafik**

Gjobat e caktuara për shkeljet në trafik brenda kufijve të komunave ju takojnë komunave dhe shkojnë në llogari të komunës. Mënyra e alokimit bëhet sipas Rregullores mbi Buxhetin dhe procedurave të Thesarit, duke i konsideruar pagesat që bëhen përmes SHPK dhe vendimeve të Gjykatave.

#### **Neni 16**

##### **Gjobat për Shkeljen e Rregullore Komunale**

Komunat kanë të drejtë të caktojnë gjoba dhe masa të tjera për shkelje rregulloreve komunale të miratuara nga Kuvendi. Lartësi e gjobës dhe/ose ashpërsia e masës mund të bazohet në rëndësinë e shkeljes dhe në shpenzimet ligjore, gjyqësore dhe administrative të nevojshme për mbledhjen e gjobave.

#### **Neni 17**

##### **Ndalesat në Tarifa dhe Ngarkesa Komunale**

Këto që vijojnë nuk lejohen të imponohen nga autoritetet komunale:

- a. Çdo ngarkesë që ka të bëjë me lejimin e koncesioneve për të vepruar më gjerë në Kosovë
- b. Çfarëdo ngarkese që ka të bëjë me regjistrimin e aktivitetit afarist ose tregtar për të operuar brenda Kosovës (kjo nuk parandalon që aktivitetet afariste ose tregtare të kërkojnë marrjen e lejeve për të operuar brenda komunës)

*HK*



c. Çdo ngarkesë për regjistrimin e automjeteve të licencuara që të operojnë brenda Kosovës (kjo nuk përjashton kërkesën e caktimit të lejeve për automjete që do të marrin banorët e komunës për qëllime të parkimit ose privilegjeve tjera për banorët lokal, të cilat nuk u ofrohen jo-rezidentëve).

**Neni 18**  
**Të Hyra të tjera të Lejuara**

Të hyrat vetanake të cekura në këtë udhëzim nuk janë gjithëpërfshirëse. Komunitet mund të u takojnë edhe të hyra të tjera vetanake të lejuara brenda përgjegjësi të caktuara nga legjislati në fuqi.

**Neni 19**  
**Hyrja në Fuqi**


19.1 Ky Udhëzim Administrativ hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe Ministri për Administrimin e Pushtetit Lokal.

19.2 Dispozitat e akteve nënligjore që janë në kundërshtim me këtë udhëzim administrativ shfuqizohen.



Haki Shatri  
Ministër

Ministria e Financave dhe Ekonomisë



Lutfi Haziri  
Ministër

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

PRISHTINË

DATA 12 shkurt 2007